



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Datë: 10.09.2020

Konform nenit 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 6, pika 5 e Rregullores së Punës së KRPP-së, duke u bazuar në Ligjin Nr. O2/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, si dhe duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë, Nr. 01/13 dhe Nr. 04/13 të dt. 13.07.2020, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, nxjerrë këtë:

NJOFTIM

Për të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE) për të bërë më të lehtë procesin e tenderimit, për shkak situatës së krijuar si rezultat i Corona Virusi-it COVID-19, Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik **Udhëzon** Autoritet Kontraktuese që të marrin masat si më poshtë :

Megjenëse kërkesa për Sigurimin e Tenderit sipas LPP-së nuk është mandatore , AK-të mund të mos kërkojnë një siguri të tillë. Megjithatë nëse AK-të e konsiderojnë si të domosdoshme vendosjen e një kërkesë të tillë në dokumentet e tenderimit, rekomandohet që të vendosë minimumin e kërkesës së përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 57 të LPP-së. Kjo do të thotë se në rast se AK vendos të detyrojë depozitim të sigurisë së tenderit, **shuma e sigurimit të Tenderit të kërkohet 1% e vlerës së parashikuar të kontratës publike (kontrata me vlera të mesme ose të mëdha).**

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

